



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:117768
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05511551

Ac.nr.123/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit S.Z. nga Istogu, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.Z., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...” sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “...” nr...., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.K., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.180/17 datë 21.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...” sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “...” nr...., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.180/17 i datës 21.11.2019, në pikën I, III dhe IV të dispozitivit VËRTETOHET.

II. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, mbetet e pashqyrtuar..

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.180/17 të datës 21.11.2019, ka vendosur që të Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.Z. nga Istogu. Në pikën I, të dispozitivit ka vendosur të Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “....”, Bulevardi Dëshmoret e Kombit Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit për aksidentin e datës 26.04.2017, për 70% të përgjegjësisë, të paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material

- për dhimbjet e përjetuara fizike 2,100.00 Euro.

- për shkak të frikës së përjetuar 1,400.00 Euro.
- për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm për jetë 3,500.00 Euro.

Dëmi material

- Në emër të shpenzimeve të shërimit 464.77 Euro.
- Në emër të trajtimit-rehabilitimit fizio - terapeutik 175.00 Euro.

Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të Refuzohet pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditësit S.Z. nga Istogu, përtej shumës së gjykuar, në pikën I, në diapozitivin e këtij aktgjykimi, për aksidentin e dt. 26.04.2017, për shumat e specifikuara si më poshtë

Dëmi jo material

- për dhimbjet e përjetuara fizike 900.00 Euro.
- për shkak të frikës së përjetuar 600.00 Euro.
- për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm për jetë 1,500.00 Euro.

Dëmi material

- Në emër të shpenzimeve të shërimit 795.48 Euro.
- Në emër të trajtimit-rehabilitimit fizio terapeutike -
- Në emër të ushqimit të përforcuar 100.00 Euro.
- Ndihmë dhe kujdes të huaj 150 Euro.

Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E...” sh.a., Bulevardi Prishtinë, që shumat e gjykuara, si në pikën I, në dispozitiv të këtij aktgjykimi, t’i paguaj me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dt.12.11.2019 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Në pikën IV, të dispozitivit ka vendosur që të Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E...” sh.a., Bulevardi Prishtinë, që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,143 Euro, e të gjitha këto t’i përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, ashtu që aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe paditësit t’i gjykoj shumat më të ulta në emër të shpërblimit të dëmit nga aksidenti në trafik.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 12.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtresën e datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar që të Miratohet

kërkesëpadia e paditësit S.Z. nga Istogu për kompensim të dëmit jomaterial dhe material dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E...”, për shkak të lëndimeve të pësuar si pasojë e aksidentit të datës 25.03.2015, ti paguaj secilën veç e veç dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 3.000 €, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2.000€ dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor 5.000€, në emër të ushqimit shumë prej 100 €, në emër të ndihmës së personit të tretë shumë prej 150 €, në emër të rehabilitimit klimaterik, shumë prej 250 €, në emër të shpenzimeve materiale të shërimit sipas faturave shumë prej 1,260.25 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 12 % vjetore konform nenit 26 par. 6 të Ligjit për Autopërgjegjësinë, e cila fillon të rrjedh nga dita e dorëzimit të kërkesës te e paditura 09.06.2017 e deri në pagesën përfundimtare në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore të përshkruara si në parashtresën për precizim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.180/17, të datës 21.11.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se nga provat e administruara e veçanërisht nga deklarimi i të autorizuarve të palëve ndërgjyqësve gjykata ka konstatuar se me datën rreth orës ... minuta në aksin rrugor I...-..., në dalje të ..., përballë pompës së derivateve “...”, ka ndodhur një aksident i komunikacionit ku ishin të involvuara një automjet dhe një traktor – të cilin e drejtonte paditësi. Nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti Naser Nimanaj me datë 24.06.2019, raporti i Policisë me nr. i datës 26.04.2017 dhe nga dokumentacioni mjekësor gjykata erdhi në përfundim se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 26.04.2017 dhe si pasojë e këtij aksidenti të komunikacionit rrugor paditësi S.Z. pëson lëndime të rënda trupore. Mbështetur në ekspertizën e komunikacionit gjykata ka konstatuar se kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë 70% (kontribut primar) të të siguarit të paditurës dhe 30% përgjegjësisë në bazë të kontributit sekondar ka paditësi S.Z. në shkaktimin e këtij aksidenti. Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Enver Mujaj ortoped - traumatolog dhe Dr. Muhamet Halitaj psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore të datës 05.09.2019, kanë konstatuar se paditësi si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar ndrydhje koke dhe trupi, plagë prerëse shqyese në kokë, thyerje e unazës së dytë lumbale, të cilat lëndime, kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, në kohëzgjatje prej 2 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 3 javë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët vazhdon edhe sot e kësaj dite. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 2 orë dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët që ka zgjatur 5 muaj. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 javë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 1 javë. Terapia dhe rehabilitimi ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditë. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor i shprehur në shkallë prej 7 % sipas tabelës për përcaktimin e invaliditetit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136 paragraf 1, 140, 159 paragraf 1, 169, 174 dhe 184 të LMD-së, nenit 26 paragraf 6 të LSDA-së, lidhur me nenet 7 dhe 319 të LPK-së. Për kamatën ka vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë gjen se në këtë rast përgjegjësia është e ndarë 70 % për të paditurën dhe 30 % për paditësin. Këtë përfundim gjykata e mbështet në provat e administruara e në veçanti në vlerësimin e ekspertit të komunikacionit rrugor, Inxh. i dipl. Naser Nimanaj të datës 24.06.2019, nga ku rezulton se përgjegjësia për 70%, e të paditurës konsiston në faktin se i njëjti ka drejtuar automjetin me shpejtësi të lëvizjes rreth 75 km/h e cila ishte dukshëm me e madhe se ajo e lejuar prej 50 km/h. Shpejtësia e pa përshtatur krahasuar me atë të lejuar që ka nxitur të bëjë tejkalim të pasigurt dhe nuk ka mundur të ketë nën kontroll automjetin përkundër reagimit për frenim të vullshëm, përderisa me pjesën ballore të anës së djathë e godet traktorin në pjesën anësore të majtë i cili ishte duke u kthyer majtas ku në këtë rast edhe shpejtësia e madhe ka ndikuar në pasojat më të mëdha të aksidentit. Përgjegjësia për 30%, e paditësit konsiston në lëshimin që ka bërë duke ndërmarr veprimin e ç'kyçjes - kthimin majtas pa u bindur se janë plotësuar kushtet për kthim të sigurt, gjegjësisht pa shikuar apo duke e nënvlerësuar rrjedhjen e komunikacionit prapa tij, pasi që në momentin e tentim kthimit automjeti pasi tij A ishte në fazën e tejkalimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat, përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë....., rreth orës minuta, në aksin rrugor I - G, përkatësisht tek pompa e derivateve "...". Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te këtu e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi primare në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit i tipit transportues "...", me targa , ngjyrë, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte H.B. nga fshati Komuna e Istogut, i siguruari i këtu të paditurës. Paditësi në cilësinë e vozitësit ka përgjegjësi sekondare në shkaktimin e këtij aksidenti dhe si pasojë e këtij aksidenti, paditësi pëson lëndime të rënda trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët - këtu e paditura gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, prandaj baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit për 70% të përgjegjësisë, gjenë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit datë 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji përcaktohet se “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkëlje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë për shkak të dhembjeve fizike, frikës së përjetuar dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të përshkruar si në ekspertizë, po ashtu kanë konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 7 %, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata, e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika tek paditësi, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, e duke marr parasysh ndarjen e përgjegjësisë 70% me 30%, ka vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për shpenzimet e shërimit dhe rehabilitimit klimaterik, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të dëmit gjen mbështetje në nenin 179 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse, si pasojë e aksidentit iu kanë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova materiale si në shkresat e lëndës të cilat janë administruar si nga gjykata e shkallës së parë.

Vendimi sa i përket kamatës është marrë me zbatim të drejtë të dispozitës ligjore nga neni 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 21.11.2019, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar përderisa pala paditëse nuk ka parqitur ankesë përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.123/20, me datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli